



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rendin dhe Qetësinë Publike.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry Of Internal Affairs

KONCEPT DOKUMENT PËR RENDIN DHE QETËSIN PUBLIKE

Tetor 2018

Kapitulli 1: Hyrje

Koncepti Dokumenti për Rendin dhe Qetësin Publike është njeri ndër proceset fillestare të nevojës së plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit Nr. 03/L-142 për Rend dhe Qetësi Publike dhe si i tillë kontribuon në forcimin e prioritetit strategjik të Qeverisë nr. 2 "Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit" të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë 2018, si dhe me objektivin nr. 2 "Ruajtja dhe mbrojtja e sigurisë publike" i Planit Vjetor të Punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme 2018, me saktësisht, aktivitetin 2.2 "Avancimi i politikave në fushën e sigurisë publike". Hartimi i këtij koncepti dokumenti parashihet edhe në Planin Vjetor për Hartimin e Konceptit Dokumenteve për vitin 2018.

Inicimi i hartimit të këtij Koncepti Dokumenti për Rend dhe Qetësi Publike, ka për qëllim që të rregullohet me kornizë ligjore koherente, në bazë të zhvillimeve progresive të shoqërisë dhe nevojës që për veprimet kundërvajtëse që nuk janë paraparë në ligjin aktual të përfshihen me plotësim të njëjtit, gjithmonë duke siguruar pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe të harmonizohen masat ndëshkimore me ligjet tjera në fuqi, sidomos me harmonizimin e sanksioneve sipas Ligjit për Kundërvajtje.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe përkufizimi i çështjes/problemit kryesor

Shpjegim

Duke marrë parasysh që njëra ndër detyrat dhe autorizimet primare të organeve kompetente për zbatim të ligjit është ruajtja e rendit dhe qetësisë publike në territorin e Republikës së Kosovës, gjatë zbatimit të legjislacionit relevant në këtë fushë, këto organe kompetente janë ballafaquar me vështirësi për shkak të mos përfshirjes, inkriminimit dhe mos sanksionimit të veprave kundërvajtëse në ligjin aktual për RQP. Nevoja për plotësim të ligjit ekzistues për RQP, ka ardhur si rezultat i zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi, të cilat kanë nxjerrë në pah nevojën e menjëhershme për ndryshime ligjore. Veçanërisht, pas miratimit të Ligjit të ri për Kundërvajtje, gjatë zbatimit të ligjit aktual është hasur në vështirësi edhe në interpretimin e dispozitave shpjeguese dhe përkufizimeve në kuadër të ligjit aktual për Rend dhe Qetësi Publike.

Përmes këtij koncepti dokumenti për plotësimin e ligjit ekzistues synohet që të plotësohen ndryshohen veprat kundërvajtëse si, bezdisja publike, kërkim lëmosha, dehja në vend publik, mbikëqyrja e shkujdesur e shtazëve, mbrojtja e të miturve, vandalizmi, sekuestrimin e mjeteve dhe sendeve, mbledhja e kontributeve për përfitime personale pa arsye, sjellje arrogante, sulmi verbal, vendosja apo heqja e lajmërimeve, billbordeve, reklamave, pamfleteve në mënyrë të paautorizuar. Këto vepra kundërvajtëse ndikojnë në Rendin dhe Qetësinë Publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe tek të gjithë qytetaret pa dallim, me theks të veçantë në vendet urbane.

Në tabelën në vijim janë paraqitur trendët që kanë të bëjnë me përmasat, lokacionin dhe kohëzgjatjen e problemit. Siç mund të shihni, në tabelën e mëposhtme del se kundërvajtje janë 5.6% të numrit të përgjithshëm të veprave të raportuara gjatë viteve në Policinë e Kosovës për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Për periudhën 2014, 2015, 2016 dhe 2017, në tërë territorin e RKS-së.

DRP	Lloji i tubimit	2014	2015	2016	2017	Gjithsejtë
Prishtinë	Protesta të dhunshme apo të qeta	151	176	143	78	548
	Manifestime, koncerte	174	225	367	231	997
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	214	39	28	556	837
	PRQP	432	376	406	473	1687
Gjilan	Protesta të dhunshme apo të qeta	4	17	6	9	36
	Manifestime, koncerte	163	174	190	256	783
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	127	0	0	426	553
	PRQP	115	123	104	152	494
Ferizaj	Protesta të dhunshme apo të qeta	20	33	8	18	79
	Manifestime, koncerte	24	23	12	20	79
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	186	0	0	465	651
	PRQP	262	204	198	166	830
Prizren	Protesta të dhunshme apo të qeta	38	12	18	23	91
	Manifestime, koncerte	53	55	56	54	218
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	265	0	0	610	875
	PRQP	95	102	73	96	366
Gjakovë	Protesta të dhunshme apo të qeta	11	36	15	13	75
	Manifestime, koncerte	38	42	49	45	174
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	214	0	0	688	902
	PRQP	155	105	113	103	476
Pejë	Protesta të dhunshme apo të qeta	17	36	28	21	102
	Manifestime, koncerte	34	38	45	70	187
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	218	0	0	519	737
	PRQP	169	183	182	166	700
M.Jugu	Protesta të dhunshme apo të qeta	16	23	28	18	85
	Manifestime, koncerte	174	179	115	92	560
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	113	0	4	333	450
	PRQP	302	276	275	241	1094
M.Veri	Protesta të dhunshme apo të qeta	19	11	5	6	41
	Manifestime, koncerte	157	173	191	199	720
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	7	0	2	38	47
	PRQP	223	99	86	84	492
TOTAL	Protesta të dhunshme apo të qeta	276	344	251	186	1057
	Manifestime, koncerte	817	909	1025	967	3718
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	1344	39	34	3635	5052
	PRQP	1753	1468	1437	1481	6139

Politika aktuale

Politika aktuale, në lidhje me rendin dhe qetësinë publike rregullohet me Strategjinë për Siguri në Bashkësi, e cila mundëson që në mënyrë adekuate të adresojë situatat e sigurisë të cilat mund të jenë komplekse, si: krimi ndaj rendit publik, personave dhe pronës private e publike, mungesa e qasjes në shëndetësi, mbrojtja e pyjeve, trafiku rrugor apo siguria në shkolla, të gjitha këto elemente të cilat janë pjesë integrale e sigurisë humane. Po ashtu, ruajtja e Rendit dhe Qetësisë Publike është e rregulluar edhe aktet tjera nënligjore që ndërlidhen me ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

Organet kompetente për zbatimin e këtij ligji, në aspektin e dhënieve se pëlqimit për shfrytëzimin e pronës komunale, lokalitetit, kohës, janë kuvendet komunale, respektivisht drejtoritë për Shërbime Publike dhe drejtoritë e Inspektorateve, ndërsa në aspektin e sigurisë, zbatimin e benë Policia e Kosovës dhe Gjykatat, në rastet e ankesave ndaj vendimeve të Policisë së Kosovës si dhe rasteve (personat) që bien ndesh me këtë Ligj.

Ky koncept dokument ndërlidhet me koncept dokumentin për Tubime Publike, andaj gjatë përgatitjes se këtyre dokumenteve grupet punuese janë konsultuar mes vete, me qëllim të evitimit të duplikimeve apo mospërputhjeve në këto dy dokumente. Meqenëse nga praktika rezulton se personat juridikë apo fizikë, me të planifikuar ndonjë aktivitet kulturor apo çfarëdo qoftë ai, kanë për detyrë që fillimisht ta marrin pëlqimin nga komuna në zonën e së cilës është paraparë aktiviteti, e më pas edhe një njoftim me shkrim për Policinë lidhur me aktivitetin. Agjendën komplet duhet ta sjellin në Polici. Policia (Stacioni Policor) me këtë rast, plotëson formularin mbi paraqitjen e aktiviteteve kulturore apo çfarëdo qofshin ato (formulari gjendet në PSO-në në fjalë), dhe të njëjtin e dërgojnë për miratim në instanca më të larta të Policisë (sipas hierarkisë komanduese). Pas miratimit apo refuzimit, njoftohet paraqitësi i kërkesës në polici.

Komunat, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statuset e tyre, lëshojnë sipas kërkesave të personave fizikë dhe juridikë pëlqime për aktivitete publike (manifestimeve publike, kulturore dhe sportive).

Sipas Ligjit aktual për Rend dhe Qetësi Publike, në raste kur qytetaret me të drejtë ankohen për veprime të caktuara që cenojnë rendin dhe Qetësin Publike por Policia e Kosovës dhe Prokurori i Shtetit kanë vështirësi të marr masa ndaj kundërvajtësve për arsye se të njëjtat nuk janë të parapara me Ligjin Aktual.

Ligjet dhe aktet nënligjore

- **Ligji Nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësin Publike**

Qëllim i këtij ligji është rregullimi i sjelljes personale në mënyrë që të ruhet rendi dhe qetësia publike.

- **Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës**

Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës ku, njëra nga detyrat është edhe ruajtja e rendit dhe qetësisë publike, veçanërisht në nenin 10 të tij

janë të përcaktuara detyrat edhe autorizimet e përgjithshme të policisë së Kosovës, për parandalimin e rrezikut ndaj qytetarëve dhe për mbajtjen e rendit dhe sigurinë publike.

- **Ligji Nr. 03/L-118 për Tubime Publike**

Me këtë ligj rregullohet e drejta për tubime publike, e fjalës së lirë në tubime publike, protestave, manifestimeve publike, koha dhe mënyra e lajmërimit, detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve, ku në bazë të dhënave dhe përvojës së deritanishme në këto evenimente, tubime, protesta ka me se tepërmi raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, përkatësisht në nenin 10 të këtij ligji, është rregulluar mbrojtja e rendit dhe qetësisë publike përreth vendit ku mbahet tubimi publik.

- **Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale**

Ky ligj themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Bazuar në neni 68 .1, çdo komunë mban periodikisht së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara. Ndërlidhja me ligjin për policinë, Neni 7 Bashkëpunimi me komunitetin, paragrafi 4. Qëllimi i Këshillit të Sigurisë është që ta zhvilloj vetëdijësimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikoj brengat lidhur me sigurinë publike dhe t'i rekomandoj planet e veprimit, për t'i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe policisë.

- **Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje**

Me këtë ligj rregullohen kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje. Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike, si dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës. Sanksioni për kundërvajtje mund të parashihen vetëm në pajtim me këtë ligj. Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike, dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës. Sanksioni për kundërvajtje mund të parashihen vetëm në pajtim me këtë ligj, pasi që me ligjin aktual parashihet edhe dënimi me burg për kundërvajtës e kjo çështje është tashme e rregulluar me ligjin për kundërvajtje e që është në kolizion me këtë ligj.

- **Ligji Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë**

Shërbimet e sigurimit të tubimeve publike – nënkupton kontrollimin e hyrjes dhe daljes nga ngjarja në pajtim me Ligjin për Tubimet Publike, dhe vetëm atëherë kur tubimi është paqësor dhe i organizuar. Kompania private e sigurimit mund të aplikojë për licencë që të ofrojë shërbimet e sigurimit të tubimeve publike, e në këto evenimente; tubime, protesta, ka më së tepërmi raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike ne neni 5 format e sigurimit, shërbimet e sigurimit të tubimeve publike;

- **Ligji Nr. 05/L -022 për Armë**

Rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, transitin, shitjen, transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës të destinuar vetëm për përdorim civil.

- **Ligji Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive**

Përcaktohen masat për parandalimin, sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, obligimet e organizatorit të ngjarjeve sportive, kompetencat e organeve zyrtare për shqiptimin e masave për parandalimin, sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, kurdisjeve dhe dukurive tjera. Këshilli Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, neni 7 Këshilli Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive. , një(1) anëtarë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë;

Ligji Nr. 02/L-10 PËR PËRKUJDESJEN NDAJ KAFSHËVE

Me këtë ligj rregullohet mbajtja, kujdesi, strehimi, mbarështimi, transportimi dhe çështje të tjera të lidhura me përkujdesjen ndaj kafshëve.

- **Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma**

Përcakton se me rastin e plotësimit të nevojave për mbajtjen e tubimeve publike, organizimit të manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike, të hapura ose të mbyllura, për banorët vendorë ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësit e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njësitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë një rrugë, një pjesë të rrugës ose pjesë të qytetit, shesh ose lokacion tjetër të përshtatshëm për qëllime të tilla. Me të njëjtin vendim përcaktohen edhe rrugët e shkuarjes e ardhjes të pjesëmarrësve nga këto manifestime.

- **Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës**

Përcakton se kushdo që me përdorimin e mashtrimit ose në ndonjë mënyrë tjetër parandalon ose pengon caktimin apo mbajtjen e tubimit publik në të cilin personat kanë të drejtë sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Kur vepra penale kryhet nga personi zyrtar, në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.

Aktet nënligjore

- **Udhëzim Administrativ Nr. 02/2013 për Mënyrën e Ofrimit të Ndhmës Organeve Qeveritare nga Policia e Kosovës**, përcakton rregullat, mënyrat, format dhe procedurat e ofrimit të ndihmës nga Policia e Kosovës, institucioneve qeveritare në nivel qendror dhe lokal, si dhe institucioneve ndërkombëtare.

- **Rregullorja për Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike**, përcakton llojet e objekteve të përkohshme kushtet dhe procedurat për vendosjen, ndërtimi dhe largimi i objekteve në pronën publike, në të cilën komuna e ka të drejtën e udhëheqjes. Objekte të përkohshme konsiderohen tendat e hapura lëvizëse, me mekanizëm dhe me elemente montuese nga materiali pleksiglas.
- **Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 03/2016 për Leje për Lëvizje me Armë**, përcakton procedurat dhe kriteret për lëshimin dhe përdorimin e lejes, ndërsa sa i përket lëvizjes me armë, leja për lëvizje me armë i lëshohet personit juridik dhe personit fizik nga organi kompetent, me të cilin personit juridik i njihet e drejta e lëvizjes nga depoja në vendin për gjah, shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport për armët e koleksionit, të lejuara me leje përkatëse ose për ekspozitë, kurse për personin fizik me leje përkatëse për armë i njihet e drejta për lëvizjen nga vendbanimi i personit fizik në vendin për gjah ose shenjëtari, ose në vendin për riparim dhe transport të armëve të koleksionit për ekspozitë.
- **Udhëzimi Administrativ nr. 11/2012 – (MPB) mbi Masat, Autorizimet dhe Detyrat e Kompanive Private të Sigurimit**
Kompanitë private të sigurimit, të licencuara në fushën e shërbimeve të sigurimit të tubimeve publike, janë të autorizuar të kryejnë aktivitetet operacionale, të vlerësojnë rrezikun dhe të hartojnë Planin e Sigurisë. Të bëjnë organizimin dhe përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve të sigurisë për kryerjen e detyrave për sigurimin e tubimeve publike në bazë të Planit të hartuar të sigurisë, të propozojnë masa të obligueshme dhe shtesë sigurie organizatorit të tubimit, të përgatisin dhe zbatojnë planet alternative në rast se tubimi publik bëhet jopaqësore deri në marrjen e kontrollit nga policia, si dhe detyrat dhe obligimet tjera të parapara me ligj.
- Policia e Kosovës ka hartuar Procedurat Standarde të Operimit me nr. referues DDO – 04/026/ 2013, të cilat janë në harmoni me Ligjin për Tubime Publike, më titull: “Sigurimi Policor në manifestime publike, kulturore e sportive”, me anë të së cilës është e rregulluar çështja e paraqitjes së aktivitetit në Polici nga institucionet tjera, e po ashtu edhe e angazhimit policor në aktivitetet në fjalë.

Shpenzimet aktuale

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e Departamentit për Operacione në kuadër të Policisë së Kosovës për vitin 2015 dhe 2016, nga pasojat e veprave kundërvajtëse të Ligjit për Rend dhe Qetësi Publike.

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti i Policisë së Kosovës	1,886,893.00 €	1,690,393.00 €	1,690,393.00 €
Shpenzimet tjera: Dëmet në pronën publike, dëmet në pronën private, Lëndimet e policeve, pagesa jashtë orarit të punës, karburantet, ushqimi.	308,285.29 €	----	----
Financimi nga donatorët	442,743.42 €	4,652.72 €	-
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave	----	----	----

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Në qoftë se organet e zbatimit të ligjit vazhdojnë me zbatimin e ligjit aktual, atëherë këto organe do të ballafaqohen me probleme të paraqitura në këtë koncept dokument, siç janë: mos sqarimi dhe kualifikimi i duhur i disa llojeve të veprave penale dha atyre kundërvajtëse, mos harmonizimi i gjobave, sanksioneve të ligjit aktual me ligjin e ri për kundërvajtje, si dhe zbrazëtitrat e tjera ligjore.

Për me tepër, mos ndryshimi i këtij ligji dhe harmonizimi i tij me ligje të tjera, duke siguruar largimin e kolizionit apo dualizmave, do të mundësonte që zyrtarët gjatë zbatimit të këtij ligji për veprimet kundërvajtëse apo penale, t'u lihen në diskrecion vendosja sipas njohurive të tyre. Kjo nënkupton që, ligji aktual, përveç që nuk mbulon të gjitha veprimet e paraqitura që janë në interes të qytetarëve dhe mbulojnë fushën e rendit, sigurisë dhe qetësisë publike është në kolizion me Projektligjin për zhurma, Ligjin për kujdesin ndaj kafshëve dhe Ligjin për Kundërvajtje .

Përvoja nga shtetet tjera

Nëse shohim dhe vlerësojmë veprimet e shteteve në rajon si, Shqipëria, Mali i Zi , Kroacia dhe Maqedonia të njëjtat kanë rifreskuar Ligjin për Rend dhe Qetësi Publike, në bazë të zhvillimeve shoqërore, ndërrimit të sistemit qeverisës, paraqitjes se nevojës për sanksionimin e veprimeve që bie ndesh me rendin dhe qetësin publike, duke pas parasysh gjithmonë hierarkinë e ligjeve pozitive të vendit, duke mos dyfishuar ligjet dhe ndarjen e Veprave Penale me ato kundërvajtëse, sidomos në rendësin apo shkaktimin e pasojës nga kundërvajtësit apo kryesitë e veprave penale. Vendet e BE-së dhe të rajonit janë të gjitha nënshkruese të **Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, si dhe konventave e kartave tjera që garantojnë këto te drejta. Të njëjtat janë te përfshira edhe në aktin më të lartë juridik dhe politik të Republikës së Kosovës. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë, ruajtjes se rendit dhe qetësisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.

Duke mos ndaluar kufizimet e ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Për hartimin e këtij koncept dokumenti, janë konsultuar disa dokumente krahasuese, të hartuara nga institucione të ndryshme brenda RKS, duke filluar nga Kushtetuta e RKS dhe dokumente nga ligjet që rregullojnë të njëjtën çështje në rajon e më gjerë.

Për me tepër politikat e ardhshëm që kanë të bëjnë me rendin dhe qetësinë publike do të bazohen në përvojat dhe praktikën e shtetit Kroat si vend anëtar i Bashkimit Evropian.

Kapitulli 3: Synimet dhe Objektivat

Synimi:

Synimi i këtij koncept dokumenti është që të plotësohet ligji aktual për Rend dhe Qetësi Publike, përfshirë harmonizimin e dispozitave përkatëse të këtij ligji me Ligjin për Kundërvajtje dhe ligjet e tjera relevante.

Objektivat:

Objektivi 1: Ngritja e nivelit të sigurisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;

Objektivi 2: Zvogëlimin dhe trajtimin e veprave kundërvajtëse që ndërliken me Rendin dhe Qetësinë Publike;

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni Status Quo (asnjë ndryshim)

Në qoftë se organet e zbatimit të ligjit vazhdojnë me zbatimin e ligjit aktual, atëherë këto organe do të ballafaqohen me probleme të paraqitura në këtë koncept dokument, siç janë : sqarimi, dallimi dhe kualifikimi i duhur në mes të disa veprave penale dhe atyre kundërvajtëse, mos-harmonizimi i sanksioneve të ligjit aktual me ligjin e ri për kundërvajtje, si dhe zbrazëirat e tjera ligjore.

Për me tepër, mos ndryshimi i këtij ligji dhe harmonizimi i tij me ligje të tjera, duke siguruar largimin e kolizionit apo dualizmave, do të mundësonte që zyrtarët gjatë zbatimit të këtij ligji për veprimet kundërvajtëse apo penale, t'u lihen në diskrecion vendosja sipas njohurive të tyre. Kjo nënkupton që ligji aktual, përveç që nuk mbulon të gjitha veprimet e paraqitura që janë në interes të qytetarëve dhe mbulojnë fushën e rendit, sigurisë dhe qetësisë publike është në kolizion me Projektligjin për zhurma, Ligjin për kujdesin ndaj kafshëve dhe Ligjin për Kundërvajtje .

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Politika ekzistuese mund të ndryshohet, duke plotësuar dhe ndryshuar ligjin aktual, përfshirë harmonizimin e dispozitave ligjore përkatëse të këtij ligji me Ligjin për Kundërvajtje dhe ligjeve të tjera relevante.

Neni 3 i ligji aktual në paragrafin e fundit përkufizimi “**Organi Kompetent**” nënkupton vetëm MBP-në, kurse në ligjin pasues do të plotësohet dhe ndryshohet duke përfshirë edhe institucionet tjera përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7 paragrafi 1 i Ligjit aktual parasheh: “Kush do që përfshihet në një akt seksual të prostitucionit, dënohet për kundërvajtje”. Ky paragraf duhet të plotësohet dhe ndryshohet duke bërë dallimin e qartë të veprimeve të subjektit, me qëllim të qartësimit të saktë ndërmjet elementeve kundërvajtës dhe veprës penale. Po ashtu duhet të specifikohen kompetencat e inspektorëve komunal, ministrive, përfshirë edhe Inspektoratin e Punës, në qoftë se këto veprime behën nëpër lokale afariste. Gjithashtu duhet të bëhet dallimi në mes prostitucionit në vende publike- hapësira të hapura dhe të mbyllura.

Neni 8 i Ligjit aktual, i cili parasheh Bezdisjet Publike – Shkeljet që kanë të bëjnë me zhurmën ka paqartësi dhe duhet të sqarohet dhe përcaktohet, si të bëhet matja e volumit të zërit, me çka do të matet volumi i zërit dhe nga kush do të matet dhe nga cili organ kompetent. Duhet të bëhet harmonizimi i orareve të punës sipas lejeve që i marrin lokale nga Kuvendet Komunale, pra lejet që lëshohen nga Komunitat të harmonizohen me Ligjin për kundërvajtje. Çështja tjetër, e cila duhet të rregullohet më këtë nen është edhe dallimi në mes zhurmës në vendet urbane, rurale dhe lokacione tjera, pastaj të dallohet zhurma në hapësira dhe objekte të mbyllura, përfshirë edhe dispozitat që parashohin dhe sekuestrimin e mjeteve që kanë shkaktuar zhurmë siç janë veglat muzikorë të gjitha llojeve si mekanike dhe elektronike. Në kuadër të këtij neni të përcaktohet qartë, kush i shqipton sanksionet kundërvajtës, gjykata, autoritetet policore apo inspektorët. Po ashtu të specifikohen llojet e zhurmës sepse zhurmë nuk bëhet vetëm nga lokale e natës mund të behën edhe nga mjete mekanike siç janë : gjenerator, mjetë të renda të punës, automjete të ndryshme mjete motorike, nga sirenat ose alarmet e ndryshme, si dhe zhurmat nga objektet e kultit si Xhamitë, Kishat dhe objektet e tjera fetare.

Të specifikohet pajisja (mjeti) për matje të volumit të zërit, të hulumtohet se me cili mjet aktual në rajon bëhet kjo matje dhe në bazë të specifikave, të përcaktohet (rregullohet) me nën të veçantë. Me zbatimin dhe mbikëqyrjen e kësaj dispozite duhet të merret Inspektorët Komunal. Sepse, me vetë faktin se komuna lësho leje individuale për bizneset, kjo bie në domenin e tyre, edhe për faktin se janë të njoftuar me listat se cilat lokale deri në cilën kohë mund të operojnë, po ashtu janë më të informuar për çdo ndryshim apo afat në raport me biznesin e caktuar.

Projektligji për Mbrojtjen nga Zhurma, në asnjë nen nuk parasheh përfshirjen e PK në zbatimin e tij, mirëpo duke pas parasysh thirrjet e Qytetarëve në PK përmes 192 dhe 112 dhe ankesave për zhurmë sidomos në Objektet Kolektive dhe Lokaleve të natës duhet të vendoset një nen i ri në ligjin pasues ku sanksionon prishjen e rendit dhe qetësisë publike.

Neni 9 i ligjit aktual parasheh Dehjen në vend publik, konkretisht, kushdo që në vend publik shfaqet dukshëm i dehur ose nën ndikim të substancave të kontrolluara narkotike jo të përdorura sipas terapisë dhe vë në rrezik veten, personat e tjerë ose pasurinë apo shqetëson qytetarët dënohet për kundërvajtje. Ky nen duhet të plotësohet dhe ndryshohet duke përcaktuar sasinë e lejuar të alkoolit, si mund ta dimë ne si organ kompetent se një kundërvajtës është i dehur, si mund ta dëshmojmë një gjë të tillë para organit kundërvajtës, sanksionin kundërvajtës ndaj tij. Po ashtu edhe sa i përket substancave narkotike të kontrolluara si mundemi ne ta vërtetojmë se një kundërvajtësi është nën ndikim të këtyre substancave pa ndonjë raport mjekësorë ose analize mjekësorë e cila e vërteton një gjë të tillë.

Neni 10 i ligjit aktual parasheh Kërkimin e Lëmshës në vend Publik, por paragrafi 1 i këtij neni duhet të plotësohet dhe ndryshohet edhe nëse kundërvajtësi është shtetas i huaj, sepse gjate praktikës ne teren shumicën e rasteve të lëmsh-kërkuesve e kemi pasur me shtetas të huaj. Po do të përcaktohet se ndaj kujt të merren masa nëse lëmsh-kërkuesi është fëmijë, ndaj prindit të fëmijës ose kujdestarit. Pastaj do të përcaktohet nëse lëmsh-kërkuesi është shtetas i huaj, masat që do të ndërmerren ndaj tij, si dënimi dhe debimi nga shteti jone, si dhe do të dallohet kërkimi i lëmshës në vende publike dhe në lokale të mbyllura.

Neni 12 i ligjit aktual parasheh Mbikëqyrjen e shkujdesur të shtazëve,, i cili nene do të plotësohet dhe ndryshohet duke përcaktuar sanksionet ndaj pronareve dhe personave që në atë moment është në shoqërim të kafshës, nëse kafshët e frikësojnë, shqetësojnë, sulmojnë ose lëndojnë ndonjë person. Gjithashtu tek rastet e kafshëve pa kujdesie, qenet endacak dhe kafshët tjera si të vepronet kush do të jete përgjegjës nëse shkaktohen pasoja nga këto kafshe të cilat nuk kanë pronare. Të behet Harmonizimi me Kodin Penal të RKS-se.

Po ashtu do të rregullohet edhe çështje e ndalimit, lëvizjes, qëndrimit dhe kullotjes së bagëtive në mjedise të ndryshme të qyteteve – vende urbane, mbajtja e shpendëve dhe kafshëve shtëpiake në mjedise të banimit kolektiv në qytet dhe pjesët e tyre, përveç nëse lejohet ndryshe me ndonjë ligj në fuqi. Vendosija e mbrojtjes së gojës së qenve gjate shëtitjes, masat sanksionuese për shoqëruesin e kafshës kur kafsha e kryen nevojën fiziologjikë edhe i njëjti nuk ndërmer veprime për pastrimin e ambientit, përfshirë edhe të drejta dhe obligimet e tjera të pronareve të tyre.

Neni 13 i ligjit aktual parasheh Mbrojta e të Miturve,, i cili nene duhet të ndryshohet plotësohet, duke bere me të qartë çartë se qëndrimi i të miturit në lokal ku ka alkool sanksionohet sipas këtij neni, por të specifikojë çartë nëse të miturit i ofrohet alkool nga pronari i lokalit apo dikush tjetër, po ashtu të specifikohet edhe masa ndëshkuese nëse të miturit i ofrohen pije alkoolike, të specifikohet koha e frekuencimit, pasi në raport me moshën e të miturve nuk lejohet pirja e alkoolit as në orët tjera ku sipas dispozitivit e ndalon vetëm prej orës 22:00-07:00 (24h).

Neni 17 i ligjit aktual parasheh Vandalizmin, i cili nen do të plotësohet dhe ndryshohet sa i përket llojit të demit, duke u harmonizuar me Kodin Penal të RKS-se, të dihet vlera e demit të shkaktuar. Do të përcaktohen edhe masat përkatëse të cilat do të jene në përputhje me pasojën ose lartësinë e demit të shkaktuar.

Neni 19 Ligjit Aktual parasheh Sekuestrimin e mjeteve dhe sendeve,, i cili nen do të plotësohet dhe rregullohet duke harmonizuar me ligjin për kundërvajtje dhe Kodin Penal, për çështje që kanë të bëjnë konfiskimi e mjeteve të përdorura gjate sjelljes arrogante nga organi kompetent si

p.sh. shufra metalike, boksa hekurit , shkopinj druri, mjeteve te zërimit si atyre mekanike dhe elektronike qe përdoren për muzike dhe për pune qe shkaktojnë zhurme.

Neni 20 i ligjit aktual parasheh Mbikëqyrjen, sipas te cilit nen përgjegjës për zbatim te këtij Ligji është vetëm Ministria e Punëve te Brendshme, prandaj ky nen do te plotësohet dhe ndryshohet me dhenjen e kompetencave mbikëqyrëse edhe institucioneve të tjera Qendrore dhe atyre lokale.

Me ligjin pasues do të rregullohet edhe Mbledhja e kontributeve për përfitime personale pa arsye apo për Kontribute vullnetare për te deklaruar qëllime humanitare (Mbledhja e kontributeve vullnetare nga kompani apo persona te ndryshëm pa autorizim përkatës institucionale (Arsyetim-persona te ndryshëm zakonisht në ditë tregu dalin dhe lypin me foto nëpër lokale të ndryshme – pa autorizime nga institucionet përkatëse).

Me ligjin pasues do te rregullohet edhe çështja e vendosjes apo heqjes se lajmërimeve, billboardëve, reklamave, pamfeltëve etj., ne mënyrë te pa autorizuar, , vetëm për çështjet te cilat aktualisht nuk janë te rregulluar me aktet normative te institucioneve përkatëse, qoftë te atyre te nivelit qendror, ashtu edhe te atyre te nivelit lokal.

Sjellja arrogante: “kushdo që nxit apo merr pjesë në përleshje” - nuk është e mjaftueshme për t’i inkriminuar të gjitha sjelljet e prishjes së RQP-së në këtë mënyrë dhe nuk korrespondon mjaft mire me titullin qe e ka kjo kundërvajtje. Besojmë qe do te ishte më mirë qe te përshkruhen sa më shumë situata të mundshme qe e përfshijnë këtë mënyrë të prishjes së RQP-së, si, p.sh., kushdo që me veprimet e tij nxit, provokon, grindet, kërcënon, përdor fjalë ofenduese e fyese, ka sjellje të pahijshme, poshtëruese, nënçmuese, merr pjesë në përleshje etj. Ka raste sidomos kur grupet e të rinjve po përleshesh e rrahësh mes vete por pa lëndime të dukshme trupore, besojë se kjo do të mund të përfshihej me këtë rast si pjesëmarrje në përleshje, sjellje huligane, vandale, sidomos kur janë një numër i madh të përfshirë në kësi rastesh e shpesh here nuk po dihet saktë se kush kënd e ka goditur dhe shprehja pjesëmarrje në përleshje do të ishte shumë e përshtatshme për ta përfshirë këtë sjellje jo të mire.

Sulmi verbal – edhe ky titull nuk korrespondon me përmbajtjen e kundërvajtës, është e nevojshme qe të përfshihet një kundërvajtje për sharje, fyerje e sjellje ofenduese, poshtëruese, përlulëse e kërcënuese ndaj personave zyrtar dhe te tjereve gjatë ruajtjes së RQP-së.

Me ligjin pasues do te rregullohet edhe çështja ne lidhje me shqetësimet, fyerjet, nënçmimet, linçimet, shantazhet, detyrimet, kërcënimet, etj, te kryera përmes pajisjeve elektronike apo internetit, duke i harmonizuar me Kodin Penal dhe legjislacionin tjetër relevant.

Neni 11 i ligjit aktual do të plotësohet dhe ndryshohet edhe me çështjet ndalimit te grafitëve qe përmbajnë imazhe negative te personaliteteve shtetore.

Ne plotësim ndryshimin e ligjit aktual do te rregullohet edhe çështje e heqjes, dëmtimit, përdhosjes apo fyerjes se simboleve shtetërore, ofendimin e dëshmorëve të kombit përfshirë edhe Shkrimi nëpër mure i simboleve të ndryshme apo vizatimeve pa autorizim

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Çdo ndryshim i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual, përfshinë në vete edhe ndryshimin e politikave dhe legjislacionit përkatës në këtë fushë, sepse e terë fushëveprimtaria e institucioneve përkatëse, në realizimin e misionit të tyre, është e bazuar në politika dhe legjislacionin përkatës. Çdo ndryshim i qasjes së zbatimit të ligjit aktual, nuk do të rezultonte me një përmirësim të gjendjes aktuale, sepse problemet e lartcekura nuk mund të evitohen pa plotësim ndryshimin e ligjit aktual apo nxjerrjes së një ligji të ri për këtë çështje, duke harmonizuar këtë ligj me legjislacionin tjetër relevant. Prandaj, duke pasur parasysh këtë fakt, çdo ndryshim i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual nuk do të siguronte rezultatet e kërkuar në evitim të problemeve të lartcekura dhe rregullimin e tyre, por vazhdimisht mekanizmat përkatës shtetërore do të kenë vështirësi në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

Me këtë ndryshim të këtij ligji do të definohej me qartë disa nga llojet e veprave kundërvajtëse si, bezdisja publike, kërkim lëmosha, dehja në vend publik, mbikëqyrja e shkujesur e shtazëve, mbrojtja e të miturve, vandalizmi, sekuestrimin e mjeteve dhe sendeve, mbledhja e kontributeve për përfitime personale pa arsye, sjellje arrogante, sulmi verbal, vendosja apo heqja e lajmërimeve, billbordeve, reklamave, pamfleteve në mënyrë të paautorizuar, si dhe evitimi i kolizionit në mes ligjit ekzistues dhe ligjit të ri për kundërvajtje.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Zbatimi i ligjit aktual i RQP nuk plotëson nevojat aktuale të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike	Plotësimi i ligjit aktual, duke filluar nga përkufizimet e përgjithshme, plotësimi me nene që sanksionojnë veprimet e lartcekura si dhe plotësimin e autoriteteve dhe përgjegjësisë/roleve të tyre që merren me zbatimin e tij	Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual do të jetë e pamundur, për faktin se në ligjin aktual janë vërejtur disa zbraçetira ligjore dhe disa dispozita të cilat kanë nevojë për harmonizim

			edhe me ligje të tjera, e sidomos edhe me Ligjin e ri për Kundërvajtje.
Segment i popullsisë / sektori / rajoni i synuar	Republika e Kosovës	Republika e Kosovës	Republika e Kosovës
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - portofol i qeverisë (kush), sektori privat, qytetarët.	MPB/PK	MPB/PK, inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, ministritë, kompanitë e sigurimeve private, OJQ-të, organizatat e ndryshme si dhe të gjithë qytetarët e Kosovës.	MPB/PK, inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, ministritë, kompanitë e sigurimeve private, OJQ-të, organizatat e ndryshme
Administrimi, zbatimi i programit ose shërbimit	MPB/PK, inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, ministritë, kompanitë e sigurimeve private	MPB/PK, inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, ministritë, kompanitë e sigurimeve private	MPB/PK, inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, ministritë, kompanitë e sigurimeve private
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet në ligjet ekzistuese, zbatimi dhe dënimet.	Pa ndryshime	Kodin Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Kundërvajtje, Ligji për Tubime Publike, Ligji për Vetëqeverisje Lokale.	Pa ndryshime
Stimujt ose stimujt jo ekonomik - subvencione	Buxheti i Republikës së Kosovës	Buxheti i Republikës së Kosovës	Buxheti i Republikës së Kosovës

apo taksa			
Fushata të edukimit dhe komunikimit	MPB/PK dhe donatorët	MPB/PK dhe Donatorët	MPB/PK dhe donatorët
Udhëzimet dhe kodet	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Afatet kohore - kur opsioni bëhet efektiv	Vazhdon zbatimimi i ligjit aktual	Janar 2019	Vazhdon zbatimimi i ligjit aktual

Si opsion i rekomanduar është plotësim-ndryshimi i ligjit aktual, apo nxjerrja e ligjit të ri për rendin dhe qetësinë publike, i cili do të shfuqizonte Ligjin nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike.

Kapitulli 6: Analiza e Opsioneve

Përfitimet

1. Opsioni 1: Ky opsion nuk do të ketë përfitime sepse mos plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit aktual, përfshirë harmonizimi e dispozitave të këtij ligji me dispozitat e ligjeve të tjera relevante do të krijonte vështirësi të vazhdueshme në praktikë dhe njëkohësisht nuk do të ketë përmirësim të gjendjes aktuale në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.
2. Opsioni 2: Me plotësim ndryshimin e këtij Ligji do të behet harmonizimi e dispozitave të këtij ligji me Ligjin për Kundërvajtje, Kodin Penal dhe me dispozitat e ligjeve të tjera relevante, do të lehtësonte zbatimin në praktikë dhe njëkohësisht do të ketë përmirësim të gjendjes aktuale në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike
3. Opsioni 3: Çdo ndryshim i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual, nuk do të rezultonte me një përmirësim të gjendjes aktuale, sepse problemet e lartcekura nuk mund të evitohen pa plotësim ndryshim e ligjit aktual, apo nxjerrjes se një Ligji të ri për këtë çështje, duke harmonizuar këtë ligj me legjislacionin tjetër relevant.

Pasojat negative

Opsioni 1: Opsioni për mos ndryshimin e ligjit aktual nuk do të ketë përfitim, por vetëm pasoja negative, për shkak të zbrazëtirave ligjore, paqartësive të disa dispozitave dhe nevojës për harmonizimin me Ligjin për Kundërvajtje, Kodin Penal dhe me dispozitat e ligjeve të tjera relevante.

Opsioni 2: Opsioni i propozuar nuk ka asnjë pasoj negative por është opsioni ideal, sepse do të ketë ndikim pozitiv në evitimin e zbrazëtirave ligjore, konkretisht në përcaktimin e detajeve të caktuara të kornizës ligjore në lidhje me përmbajtjen e Ligjit për Rend dhe Qetësinë Publike dhe harmonizimin e tij me Ligjin për Kundërvajtje dhe Kodin Penal.

Opsioni 3: Mos ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual, nuk do të siguronte rezultatet e kërkuara në evitimin e problemeve të lartcekura dhe rregullimin e tyre, por vazhdimisht institucionet përgjegjëse shtetërore do të kenë vështirësi të vazhdueshme në përmbushjen e misionit të tyre për ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike për qytetarët e vendit.

Efektet e shpërndarjes

Kosto

Për zbatimin e këtij opsioni të propozuar, nuk krijohen kosto shtesë buxhetore, përveç atyre të parapara tashmë me Ligjin për Buxhetin, për vitin 2018.

Tutje, asnjëri nga opsionet e hartuara nuk paraqet diferencë në gjenerimin e të hyrave dhe në alokimin e shpenzimeve. Po ashtu, nuk pritet financim nga donatorët.

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	Viti aktual - (do të thotë viti kur është bërë regjistrimi, varësisht nga viti i shpalljes së ligjit).	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve.	95,595,582 €			
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave.	-			
Financimi i pritur nga donatorët.				
Opsioni 2	95,595,582 €			
Fushata e vetëdijesimit/informimit	-			
Trajnimi i zyrtarëve, pronarëve dhe operatorëve të infrastrukturës kritike	-			
Zhvillimi i udhëzimit	-			
Financimi i pritur nga donatorët.	-			

Në vazhdim do të prezantojmë mjetet financiare të ndara në bazë të kategorive ekonomike duke përfshirë periudhën 2018 – 2020.

Tabela nr. 1; Tabela në kuadër të kufirit buxhetor 2018 - 2020 - PK-së

Nr. Re.	Kategoria ekonomike	2018	2019	2020	TOTALI
1	Nr. i Personelit	9149	9149	9149	
2	Paga dhe Mëditje	68,777,003 €	70,165,892 €	71,022,883 €	209,965,779 €
3	Mallra dhe Shërbime	12,357,956 €	12,893,663 €	13,429,335 €	38,680,954 €
4	Komunalit	1,360,250 €	1,260,250 €	1,260,250 €	4,200,750 €
5	Subvencione	1,291,129 €	1,291,129 €	1,291,129 €	3,573,387 €
6	Investimet Kapitale	11,809,244	9,445,983 €	10,331,544 €	34,751,552 €
	Totali	95,595,582 €	95,056,917 €	97,335,141 €	291,172,422 €

Kapitulli 7: Konsultimi

Ky koncept dokument, ka ardhur në bazë të nevojave të rregullimit për plotësim ndryshimin e ligjit aktual. Procesi i konsultimit të jashtëm, do të bëhet sipas Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë dhe Udhëzuesit për Procesin e Konsultimeve Publike (shtator 2011), ku palëve të lartë cekura, ua kemi dërguar draftin fillestar të këtij koncept dokumentit. Nga këto konsulta, është arritur përfundimi se ndryshimet e lartpërmendura janë më se të domosdoshme. Përgatitjes së këtij KD i ka paraprirë konsultimi me publikun dhe palët e interesit, përmes platformës elektronike qeveritar për konsultimeve me publikun.

Konsultimet paraprake jenë bërë sipas rregullores me numër 09/2011, sipas nenit 7 të rregullores se punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku janë përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare si EULEXI, UNDP, dhe ICITAP.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Ky opsion për mos ndryshimin e ligjit aktual, nuk do të ketë përfitim, por vetëm pasoja negative për shkak të vështirësive në zbatim. Sa i përket pasojave negative, janë vështirësitë në zbatim të ligjit për arsye të shumë zbrazëtirave ligjore dhe paqartësive të disa dispozitave në ligjin aktual dhe harmonizimin me Ligjin e ri për Kundërvajtje.

Opsioni 2: Me këtë opsion eliminohet mundësia e interpretimeve të ndryshme dhe krijohet një qartësi ligjore. Tutje, zbatimi i këtij opsioni, nuk do të krijonte pasoja negative dhe të gjithë qytetarët do të ndikohen në mënyrë të barabartë, dhe sigurisht se do t'u lehtësonte punën edhe organeve përkatës në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

Opsioni 3: Me këtë opsion, nuk do të ketë përfitim, por vetëm pasoja negative, për shkak të vështirësive në zbatim. Dhe sigurisht qe institucionet përkatëse përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike do ta kenë të pamundur të përmbushin misionin e tyre në ruajtjen e rendit dhe qetësisë për qytetarët e vendit.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Përmes këtij koncept dokumenti, rekomandohet plotësim ndryshimi i Ligjit aktual apo nxjerrja e ligjit të ri, me të cilin do të rregullohen në mënyrë më konkrete çështjet e përcaktuara në këtë koncept dokument, të cilat do të përshtaten me praktikën më të mira në rajon dhe me gjerë duke i harmonizuar, si dhe duke i shmangur paqartësitë e dispozitave të Ligjit aktual.

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Policia e Kosovës, do të vazhdojë të jetë autoriteti i cili shërben si pikë kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me rendin dhe qetësinë publike në vazhdimësi, pa ndonjë kosto shtesë.

Duke i pasur parasysh të gjitha opsionet, si dhe pasojat negative dhe përfitimet e mundshme nga të gjitha opsionet, propozohet që të miratohet opsioni 2, si opsion më i favorshëm.

Kapitulli 10: Komunikimi

Me rastin e miratimit të koncept dokumentit, Ministria e Punëve të Brendshme do t'i njoftojë palët e interesit, dhe institucionet e tjera të Republikën e Kosovës, të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji. Njëkohësisht, përmes ueb-faqes së MPB-së, do të njoftohen edhe publiku i gjere për miratimin e këtij KD dhe për hapat e ardhshëm deri ne miratimin e ligjit të ri.